KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN KASKO DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. TERMA TE PERGJITHSHEM - a. "***Siguruesi***" nënkupton SIGAL Insurance Group sh. a, që lëshon këtë kontratë në cilesine e shoqërisë siguruese. b. "***I Siguruari***" nënkupton personin fizik ose juridik, i përcaktuar si i siguruar në policën e sigurimit dhe interesi pasuror i të cilit mbrohet nga sigurimi, kundrejt pagimit të primit. c. "***Përfituesi***" nënkupton personin fizik ose juridik të përcaktuar në Policën e Sigurimit si përfitues i dëmshperblimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i cili ka interes pasuror. d. "***Përfaqësuesi***" nënkupton personin fizik ose juridik që ngarkohet me negocimin dhe finalizimin e kontratës së sigurimit në emër të palës që përfaqëson pavarësisht nga forma apo mjeti (fizike, elektronike/online) përmes të cilit realizohet kontrata. e. "***Mjet motorik***" nënkupton një mjet që lëviz në tokë, por jo mbi shina, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysëm rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës si dhe mjete elektrike. f. "***Përdorues***" nënkupton personin/personat që përdorin mjetin motorik të siguruar, emrat e të cilëve janë të shënuar detyrimisht në kontratën e sigurimit, dhe në favor të të cilëve mbulimi sigurues është i vlefshëm vetëm për aq kohë sa është në fuqi kontrata e sigurimit ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit/pronarit të mjetit. Përdoruesi nuk konsiderohet palë në kontratën e sigurimit dhe e drejta e tij e mbulimit është e varur nga vlefshmëria e kontratës kryesore. Në rast se i siguruari dhe/ose pronari i mjetit humbet interesin e tij pasuror mbi mjetin e siguruar (p.sh. shitje, tjetërsim, humbje, asgjësim etj.), kontrata e sigurimit zgjidhet automatikisht që nga momenti i humbjes së këtij interesi, edhe pa njoftim paraprak drejtuar përdoruesit. Zgjidhja e kontratës në këto kushte prodhon efekt të menjëhershëm edhe ndaj çdo përdoruesi të shënuar në policë, i cili humbet të drejtën e mbulimit nga ai moment, pavarësisht se nuk ka qenë palë në kontratë dhe pavarësisht faktit nëse ka pasur ose jo dijeni për zgjidhjen. g. "***Kontrata***" është lidhja e marrëveshjes midis Siguruesit dhe të Siguruarit. h. "***Kushtet e Sigurimit***" nënkuptojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës për sigurimin Kasko të mjetit motorik (këto Kushte), të cilat i vihen në dispozicion të Siguruarit përpara ose në momentin e lidhjes së kontratës, pavarësisht kanalit të shitjes (fizik ose online). Pagimi i primit të sigurimit nga i Siguruari përbën shprehje të qartë dhe të pakushtëzuar të vullnetit të tij për njohjen dhe pranimin e Kushteve të Sigurimit, i mjaftueshëm më vete, pavarësisht nëse Polica është ose jo e nënshkruar. i. "***Shuma e siguruar***" nënkupton vlerën maksimale të përgjegjësisë së Shoqërisë së Sigurimit për të gjithë periudhën e sigurimit, për këtë Policë. Përllogaritja e dëmshpërblimit bëhet në përputhje me Kushtet e Sigurimit dhe rregullat e përcaktuara në to. j. "***Pjesa e zbritshme***" nënkupton vlerën e përcaktuar ose e përcaktueshme si e tillë në Policë, që në rast dëmi, zbritet nga vlera e dëmshpërblimit që paguan Siguruesi, pra mbartet nga i Siguruari dhe nuk rimbursohet nga Shoqëria e Sigurimit. Shoqëria e Sigurimit është e detyruar të paguajë vetëm pjesën e dëmit që tejkalon shumën e përcaktuar si pjesë e zbritshme në Policë. Pjesa e zbritshme zbatohet për çdo ngjarje të veçantë sigurimi dhe kërkesë për dëmshpërblim. k. "***Franshiza***" është shuma e demit, e percaktuar në Policë si e tillë, nën të cilën Shoqëria e Sigurimit nuk është e detyruar të japë dëmshpërblim. Në rast se dëmi i ndodhur është më i vogël ose i barabartë me shumën e franshizës, Shoqëria e Sigurimit nuk është e detyruar të shpërblejë dëmin. Nëse dëmi i ndodhur tejkalon shumën e franshizës, Shoqëria e Sigurimit paguan dëmin në tërësi, pa zbritur shumën e franshizës.

2**. OBJEKTI (RREZIKU) I SIGURIMIT** - Siguruesi ofron mbulim sigurues për te siguruarin dhe mjetin motorik të identifikuar në Policën e Sigurimit, duke dëmshpërblyer të Siguruarin nëpërmjet riparimit të mjetit ose pagesës në të holla, për humbjen apo dëmtimin, të plotë ose të pjesshëm, të mjetit, kur ky dëm shkaktohet nga ngjarjet (rreziqet) e parashikuara në këto Kushte të Sigurimit dhe të zgjedhura për mbulim nga i Siguruari, në përputhje me përcaktimet përkatëse të bëra në to, kundrejt pagimit të primit të sigurimit nga i Siguruari për secilin mbulim. Siguruesi nuk mbulon sigurim dhe nuk përgjigjet, në asnjë rast, për: a) fitimin e munguar (lucrum cessans), humbjet indirekte, apo çdo dëm tjetër që nuk përbën humbje apo dëmtim të drejtpërdrejtë të vetë mjetit të siguruar; b) kostot e qirasë së një mjeti zëvendësues por pa u kufizuar përfshirë humbjen e të ardhurave nga mospërdorimi i mjetit, apo çdo shpenzim tjetër që i Siguruari mund të pësojë për shkak të kohës së nevojshme për riparimin apo zëvendësimin e mjetit, përveç rasteve kur një mbulim i tillë (sipas shkronjës b) është shprehimisht i parashikuar dhe i blerë si mbulim shtesë (ekstra), sipas kushteve të veçanta të Policës.

3. **RREZIQET E SIGURUARA** - 3.1 Siguruesi, do të dëmshpërblejë të Siguruarin deri në shumën e siguruar të përcaktuar në Policën e sigurimit, për humbjet, dëmtimet e plota ose të pjesshme në mjetin motorik të siguruar, të shkaktuara nga rreziqet e e përcaktuara si të mbuluara në policën e sigurimit sipas zgjedhjes së të Siguruarit, konkretisht: 1. Dëmtimet aksidentale. 2. Thyerja e xhamave. 3.Zjarri, rrufeja, eksplozioni. 4. Katastrofat natyrore. 5. Vjedhja (vjedhja totale e mjetit). 6. Dëmtimi në parkim nga një mjet tjetër. 7. Dëmtimi nga aktet keqdashëse. 8. Vjedhje e pjesshme. 9. Autosos – Asistenca rrugore. Sigurimi i mjetit motorik mund të shtrijë mbulimin edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë "Jashtë Vendit" pasi të ketë paguar primin shtesë, duke mbuluar të gjitha rreziqet e zgjedhura nga i Siguruari sipas këtyre Kushteve, edhe kur ngjarja e siguruar ndodh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse dhe vetëm nëse ky mbulim shtesë ("Jashtë Vendit") është zgjedhur shprehimisht nga i Siguruari dhe pasqyrohet si i tillë në Policën e Sigurimit. Në mungesë të një përcaktimi të tillë në Policë, mbulimi sigurues vlen vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për rreziqet e zgjedhura nga i Siguruari.

3.1.1 **DEMTIMI AKSIDENTAL (përplasja, përmbysja) - a) Rreziqet e mbuluara** - Siguruesi dëmshpërblen të gjitha dëmet e shkaktuara mjetit motorik të siguruar si rezultat i: i. përplasjes me një objekt fiks ose të lëvizshëm; ii. daljes nga rruga apo përmbysjes së mjetit motorik. **b) Përjashtimet nga ky mbulim** - Nuk dëmshpërblehen, sipas këtij mbulimi: i. dëmet në mjetin motorik të siguruar, të ardhura ose shkaktuara si rezultat i konsumit normal, defekteve apo avarive të brendshme elektrike ose mekanike të mjetit; ii. dëmet e shkaktuara në mjetin motorik të siguruar nga persona të paidentifikuar dhe/ose për shkaqe të paidentifikuara, kur mosidentifikimi konstatohet nga i Siguruari dhe/ose nga organet shtetërore përkatëse. **Kujdes:** I Siguruari është i detyruar të fotografojë vendngjarjen dhe mjetin e dëmtuar dhe t'ia depozitojë këto fotografi Siguruesit. Në rast mosplotësimi të këtij detyrimi nga i Siguruari, Siguruesi gëzon të drejtën të refuzojë pagesën e dëmshpërblimit sipas këtij mbulimi, përveç rastit kur i Siguruari provon se kryerja e fotove ka qenë objektivisht e pamundur *(si p.sh për shkak të dëmtimeve trupore të pësuara nga vetë i Siguruari, të certifikuara nga ana mjekësore, apo rrethana të tjera jashtë kontrollit të tij që e kanë bërë të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi)*.

3.1.2 THYERJA E XHAMAVE - Thyerja e xhamave: do të kuptohet që nga plasaritja deri tek thermimi i xhamave të përparme, të pasëm, anësor, të tavaneve të lëvizshëm si dhe xhamave të fenereve të shkaktuar nga goditja e një objekti të lëvizshëm.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim: a. Dëmet e shkaktuara në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli. b. Dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katallogun e prodhimit, por që eshte vendosur (shtuar) në mjetin motorik.

3.1.3 ZJARRI, EKSPLOZIONI DHE RRUFEJA - Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet në mjetin e siguruar që vijnë ose janë shkaktuar nga: a. Zjarri dhe Eksplozioni që vijnë nga faktorë të jashtëm dhe dëmtojnë mjetin e siguruar. b. Rrufeja mbi mjetin motorik. Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim: I. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga shkaqe të brendshme (difekte teknike, elektrike, etj) të mjetit motorik. II. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, ku shkak ka qënë pirja e duhanit në mjetin motorik. III. Dëmet kur ngjarja nuk është njoftuar në polici apo në repartin zjarrfikës. IV. Dëmet e shkaktuara nga zjarri ose eksplozioni në mjetin motorik të siguruar nga persona të paidentifikuar.

3.1.4 KATASTROFA NATYRORE - Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj shkaktuar nga: Stuhia, dëbora, tufani, përmbytja, vërshimi, kur katastrofa natyrore është e njohur dhe e deklaruar si e tillë nga autoritetet përkatëse shtetërore. Siguruesi do të paguajë gjithashtu dhe dëmet e shkaktuara në mjetin motorik të siguruar nga rënia e objekteve të ndryshme, që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore. Siguruesi do të paguajë edhe dëmet në mjetin motorik të siguruar shkaktuar nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujrave edhe në rast se nuk ka ndodhur katastrofë natyrore. **Stuhi** - do të konsiderohet një çrregullim atmosferik me një lëvizje ajri me shpejtësi jo më të vogël se 17.2 m/s ose 62 km/ore e cila mund të shoqërohet me shira, dëborë ose rreshje të tjera. **Dëbora** – do të konsiderohet rreshja atmosferike e ngurtë që bie flokë-flokë nga retë në trajtë kristalesh të bardhë me formë dhe përmasa të ndryshme. **Tufani** – do të konsiderohet era e vrullshme zakonisht me shi të madh, breshër a dëborë të dendur. **Përmbytje** – do të konsiderohet dalja e ujit nga kufijtë normal të rrjedhjeve naturale apo artificiale, të liqeneve, rezervuarëve duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, digat dhe shpërndahet për shkak të rrymës së ujit me nivel të lartë si dhe vërshimi i ujit në rrugë për shkak të rreshjeve shumë të mëdha e të papritura. **Vërshimi** – Dalja e ujit të një lumi a përroi jashtë shtratit të tij, i cili derdhet me vrull e përmbyt vendin rreth e rrotull. Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim: a. Dëmet nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës. b. Dëmet e shkaktuara gjatë kalimit të lumenjve ose perrejve. c. Dëmet e shkatuara nga breshëri.

3.1.5 VJEDHJA - Vjedhja: Do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në menyrë të fshehtë, nga një ose disa persona i mjetit motorik të siguruar (vjedhja totale), apo i pjesëve, aksesorëve dhe elementëve të mjetit motorik të përfshira në katalogun e prodhimit, të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore (Prokuroria). **Tentativa për vjedhje:** Do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorik të siguruar por që nuk ka arritur të kryhet, duke shkaktuar dëme ndaj mjetit motorik. Këtu mbulohen vetëm dëmet e shkaktuara mjetit motorik si pasojë e tentativës për vjedhje të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore (Prokuroria). Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim: a. Vjedhja ose dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga i Siguruari, përdoruesit ose persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tyre, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit: b. Dëmet nga vjedhja totale, vjedhja e pjesëve, aksesorëve dhe elementëve të mjetit motorik ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brënda mjetit, mbi ose përreth tij. c. Dëmet nga vjedhja kur mjeti motorik ka qënë me një çelës. d. Siguruesi nuk do të dëmshpërbleje në rastin e vjedhjes së pasqyrave ose gomave dhe disqeve. e. Siguruesi që ka paguar shpërblimin e dëmit ka të drejte të kërkoje kthimin e shumës të paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit. f. Nëse i siguruari apo përfituesi i kontratës së sigurimit Kasko, refuzon vendosjen e paisjes GPS të kërkuar nga siguruesi ose nëse pas vendosjes pajisja GPS hiqet, dëmtohet apo nxirret jashtë funksionit nga i siguruari apo persona të autorizuar prej tij, Siguruesi lirohet nga detyrimi i mbulimit të vjedhjes së mjetit dhe rezervon të drejten e anullimit të mbulimit të këtij risku, duke ndërprerë kontratë e sigurimit Kasko në mënyrë të plotë ose të pjeshme (përjashton mbulimin e rrezikut të vjedhjes).

3.1.6 DEMTIMI NE PARKING NGA NJE MJET TJETER PA AUTOR - "Dëmtimi në Parkim nga një mjet motorik" mbulon në sigurim dëmet që vijnë si rezultat i dëmtimit të mjetit motorik, vetëm në rastet kur ai ndodhet i parkuar në një vend të caktuar dhe nuk mund të identifikohet shkaktari i aksidentit. Nuk dëmshperblehen nga ky mbulim: a. Dëmet e shkaktuara mjetit motorik të parkuar si rezultat i neglizhencës për parkim të gabuar të të siguruarit apo të autorizuarve prej tij; b. Dëmet e shkaktuara në mjetin motorik si rezultat i gabimeve apo neglizhencës së përfaqësuesve të parkingut privat, lavazhove ose serviseve; **Kujdes :** I Siguruari është i detyruar të fotografojë vendngjarjen dhe mjetin e dëmtuar dhe t'ia depozitojë këto fotografi Siguruesit. Në rast mosplotësimi të këtij detyrimi nga i Siguruari, Siguruesi gëzon të drejtën të refuzojë, pagesën e dëmshpërblimit sipas këtij mbulimi, përveç rastit kur i Siguruari provon se kryerja e fotove ka qenë objektivisht e pamundur *(si p.sh për shkak të dëmtimeve trupore të pësuara nga vetë i Siguruari, të certifikuara nga ana mjekësore, apo rrethana të tjera jashtë kontrollit të tij që e kanë bërë të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi)*.

3.1.7 AKTET KEQDASHESE - a) Për qëllim të kësaj kontrate me "akte keqdashëse" kuptohen dëmet e ndodhura në mjetin motorik të siguruar si rezultat i veprimeve të kryera me vullnet të plotë, në mënyrë të qëllimshme ose keqdashëse, nga palë të treta, pa miratimin, dijeninë dhe/ose pëlqimin e të Siguruarit, gjatë qëndrimit ose qarkullimit të mjetit. **b) Rreziqet e mbuluara** : - Mbulohen në sigurim dëmet e shkaktuara mjetit motorik të siguruar nga akte keqdashëse që synojnë dëmtimin apo shkatërrimin e mjetit me zjarr, eksploziv të qëllimshëm, ose me mjete apo mënyra të tjera. **c) Përjashtime të tjera të veçanta për këtë mbulim:** - Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim: i. dëmet e shkaktuara mjetit motorik të siguruar nga vetë i Siguruari, përfituesi, ose persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tyre. **d) Plotësimi i kushteve për dëmshpërblim:** -Për efekt të njohjes dhe dëmshpërblimit sipas këtij mbulimi, i Siguruari është i detyruar: i. të fotografojë mjetin e dëmtuar në vendin e ngjarjes; ii. të denoncojë ngjarjen pranë organeve kompetente shtetërore (Policia dhe/ose Prokuroria) brenda 24 orëve/ditëve nga momenti i konstatimit të dëmit, dhe të depozitojë pranë Siguruesit dokumentin përkatës të lëshuar nga këto organe. Mospërmbushja e njërit prej këtyre detyrimeve nga i Siguruari i jep Siguruesit të drejtën të refuzojë, pagesën e dëmshpërblimit sipas këtij mbulimi, përveç rastit kur i Siguruari provon se përmbushja e tyre ka qenë objektivisht e pamundur.

3.1.8 VJEDHA E PJESSHME - Në rastin e vjedhjes së pjesshme, siguruesi do të dëmshpërblejë të siguruarin duke e vërtetuar nga organet shtetërore për vjedhjen e aksesoreve ose elementëve të përfshira në katalogun e prodhimit. Këtu mbulohen vetëm dëmet e shkaktuara mjetit motorrik si pasojë e vjedhjes së pjesshme, të vërtetuar nga organet kompetente shtetërore. Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim në sigurim: a. Në rastet kur ato janë kryer nga vetë i siguruari apo persona të tjerë të udhëzuar apo urdhëruar prej tij ose përdorues të tjerë. b. Siguruesi nuk do të shpërblejë vjedhjet e pjesshme nga punonjësit e shërbimit të ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit. c. Siguruesi nuk do të dëmshpërbleje në rastin e vjedhjes së pasqyrave ose gomave dhe disqeve. d. Siguruesi që ka paguar shpërblimin e dëmit ka të drejte të kërkoje kthimin e shumës të paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

3.1.9 AUTOSOS - Mbulimi "AutoSOS" përbën një mbulim të veçantë sigurimi, i cili rregullohet nga kushtet e veçanta dhe skeduli i policës AutoSOS (këto të fundit "Kushtet AutoSOS"), të cilat i vihen në dijeni të Siguruarit në momentin e ofrimit të këtij mbulimi dhe përbëjnë pjesë të pandarë të kontratës së sigurimit Kasko, nëse ky mbulim është zgjedhur nga i Siguruari dhe pasqyrohet si i tillë në Policën e Sigurimit. Sipas Kushteve AutoSOS, Siguruesi ofron shërbime asistence rrugore në rast aksidenti rrugor, defekti teknik të mjetit, ose bllokimi të rrugës për shkak të kushteve të këqija atmosferike, në territorin e Shqipërisë, Ballkanit dhe Evropës, sipas shërbimeve dhe vendeve të përzgjedhura nga i Siguruari dhe të përcaktuara në skedulin e Kushteve AutoSOS. Në çdo rast mospërputhjeje mes këtyre Kushteve dhe Kushteve AutoSOS, në lidhje me mbulimin AutoSOS, do të zbatohen Kushtet e sigurimit AutoSOS.

4. **PËRJASHTIME TË PËRGJITHSHME - ÇFARË NUK ËSHTË E MBULUAR:** Siguruesi, nuk do të dëmshpërblejë, humbjet apo dëmtimet, që pëson mjeti motorik, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt, janë shkaktuar, rrjedhin ose janë rënduar gjate, në ose nga: **a.** Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprimeve të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizja seperatiste, kryengritja popullore, rebelimit, revolta, puçe, grushte shteti, eksode, akteve terroriste, trazirave, grevës, sabotimit. **b.** Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike. **c.** Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi ose gjatë proceseve te bllokimit nga Organet e Shtetit. **d.** Dëmet që shkaktohen nga përdorues te mjetit te siguruar, emrat e cilëve nuk janë shënuar si të përdorues në kontratën e sigurimit që nënkupton se janë të pasiguruar. Nuk aplikohet ky përjashtim për familjarët e pronarit të mjetit (individ), bazuar në Certifikatën Familjare. **e.** Dëmet që rezultojnë nga defekte të prodhimit, konsumi normal, defektet apo avaritë e brëndshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit. **f.**Skopjimi i gomave, dhe dëmet që pasojnë. **g.** Dëmet në mjetin motorik të siguruar në operacione të tilla si: shërbimi, riparimi, kontrolli, larja, parkimi, dorëzimi ose shitja. **h.** Dëmet e shkaktuara nga përdoruesit, të pa pajisur me dëshminë e aftësisë, liçencen në rast aktiviteti që kryehet me liçencë, ose lejen e drejtimit jo të përshtatshme për drejtimin e kategorisë ose llojit të mjetit të siguruar edhe kur këta janë të shënuar në policën e sigurimit apo familjare të të siguruarit. **i.** Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit e të drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli. **j.** Dëmet e shkaktuara në mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese etj. Siguruesi do t`i paguajë këto dëme nëse është rënë dakort më parë duke paguar një prim shtesë. **k.** Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit. **l.** Siguruesi nuk do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato. **m.** Dëmet që zmadhohen artificialisht nga i siguruari për kalimin e vlerës së franshizës, me qëllim përfitimin e mbulimit në sigurim. **n**. Dëmet e shkaktuara nga materialet apo kafshët që transportoheshin me këtë mjet.; **o**.Dëmet e shkaktuara nga rimorkiot qe i janë lidhur mjetit (aktive apo pasive). **p**.Dëmet që shkaktohen nga manovrat kur mjeti shtyhet me forcën e krahut. **q.** Dëmet qe shkaktohen kur mjeti kalon në shtigje rrugësh apo qarkullon në rrugë të pashtruara, të painventarizuara (hapesira jo për qarkullim normal dhe të zakonshëm mjetesh). **r.** Dëmet që jane shkaktuar me qëllim dhe/ose të udhëzuara nga i siguruari, nga kontraktuesi, nga përfituesi apo nga personat që bashkëjetojnë me të, nga të punesuarit e tyre, nga personat që transporton, nga ata që janë të ngarkuar për të drejtuar, riparuar apo ruajtur mjetin. **s.** Dëmet e shkaktuara nga ose tek pjesë të automjetit të cilat janë vendosur vetë nga i siguruari dhe nuk janë pjesë e katalogut të prodhimit. **t.** Dëmet që pëson mjeti motorik si rezultat i pjesmarrjes në gara përfshirë ato sportive të autorizuara apo të paautorizuara. **u.** Vjedhja e mjetit, kur për arsye të neglizhencës së të siguruarit, nuk është instaluar paisja GPS apo nuk është zëvëndësuar paisja GPS jofunksionale (të dyja këto raste të dokumentuara nga siguruesi). Vjedhja e mjetit, kur mjetit të siguruar kundër vjedhjes, i hiqet apo dëmtohet nga i siguruari, drejtuesi i automjetit, apo servisi i riparimit, paisja GPS e instaluar nga siguruesi për identifikimin e vëndndodhjes së mjetit (për ta mbrojtur nga vjedhja), nëse siguruesi ka njoftuar të siguruarin për rinstalimin e paisjes GPS dhe i siguruari nuk ka kryer ose pranuar riparimin apo riinstalimin e paisjes GPS. **v.** Fitimin e munguar për arsye të mospërdorimit të mjetit përgjatë periudhës së trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, riparimit apo zëvëndësimit të mjetit. **w.** Dëmet e ardhura mjetit të siguruar kur ky i fundit nuk ka çertifikate të vlefshme të kontrollit teknik ne momentin e aksidentit dhe aksidenti rezulton se është shkaktuar nga një problem teknik i vetë mjetit. **x.** Dëmet e shkaktuara mjetit, kur drejtuesi i mjetit largohet nga vëndngjarja pa njoftuar policinë ose pa ardhur policia në vëndin e ngjarjes. **y.** Nëse i siguruari nuk ka leje drejtimi të vlefshme për kategorinë e mjetit të siguruar që ai drejton në momentin e ndodhjes së aksidentit. **z.** Nëse nuk ka dëshmi aftësie të vlefshme për mjetin motorrik që drejton, si dëshmi taksisti për drejtimin e mjetit taksi apo dëshminë përkatëse për drejtimin e mjetit autobuz, apo respektivisht dëshminë përkatëse për çdo kategori mjeti apo qëllim përdorimi që kërkon pajisjen me dëshmi të posaçme. **zh.** Nuk mbulohen shpenzimet për ruajtjen/parkimin e mjetit; për transportin e mjetit në servisin apo destinacionin e përzgjedhur nga i siguruari nëse nuk ka përzgjedhur asistencen rrugore AutoSOS si mbulim të polices KASKO; çdo shpenzim tjetër që nuk përfshin kostot e riparimit/zëvëndësimit të mjetit të siguruar. Në çdo rast kosto e riparimit dhe shpenzimet e tjera së bashku, nuk kalojnë shumën e siguruar pas aplikimit të pjesës së zbritshme. **5**. Siguruesi, nuk do të jetë përgjegjës për humbje të mjeteve, të cilat rezultojnë të vjedhura më parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. **6**. Në çdo kërkesë, padi ose procedurë tjetër gjyqësore, ku Siguruesi, deklaron se, sipas parashikimeve të mësipërme, humbja apo dëmtimi nuk mbulohen në sigurim, barra për të provuar që kjo humbje, shkatërrim, dëmtim apo përgjegjësi mbulohet, do t'i takojë të Siguruarit.

SHTRIRJA TERRITORIALE - 7. Mbulimi në sigurim, është i vlefshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj kur kjo është kërkuar (zgjedhur nga i siguruari) dhe është paguar primi përkatës nga i siguruari. Mbulimi në sigurim jashtë territorit të Republikës së Shqiperisë përfshin shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe shtete të tjera të përcaktuara më poshtë: a. Maqedonia e Veriut; b. Kosovë; c. Mal i Zi; d. Turqi; e. Serbi; f. Bosnjë & Hercogovina, Zvicër.

SHUMA E SIGURUAR - 8. Mjeti motorik, i treguar në policën e sigurimit, mbulohet në sigurim, për një shumë maksimale të përcaktuar si e tillë në Policën e Sigurimit. **9**. Shuma e siguruar, mund të jetë e barabartë me vlerën e blerjes së mjetit motorik të ri, kur ky merret në sigurim në momentin e vënies në qarkullim për herë të parë, ose me vlerën e tregut në momentin e marrjes në sigurim. **10**. Në rast se, të dy palët bien dakord, që shuma e siguruar të jetë më e vogël se vlera e tregut të mjetit motorik, do të kemi marrjen e sigurim me nënsigurim dhe do të zbatohen procedurat e seksionit "Nënsigurimi". Nënsigurimi aplikohet për çdo rast kur shuma e siguruar e përcaktuar në policën e sigurimit është më e ulët se vlera e tregut e mjetit.

POLICA E SIGURIMIT - 11. Siguruesi, i dorëzon të Siguruarit, një dokument të firmosur nga ana e tij, Policën e Sigurimit, e cila vërteton, pranimin e Kushteve të Përgjithshme dhe të veçanta nga i Siguruari si dhe lidhjen e Kontratës së Sigurimit. **12**. Polica e sigurimit, lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të të Siguruarit "Pyetesori" ose çdo kërkese tjetër apo deklarimeve të të siguruarit gjatë proçesit të lëshimit të policës së sigurimit. Siguruesi, lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit, në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga i Siguruari në "Pyetesor" ose në çdo mënyrë tjetër gjatë procesit të marrjes në sigurim. Kërkesat, njoftimet dhe deklarimet e tjera të të Siguruarit, i bashkëngjiten fizikisht/elektronikisht Policës së Sigurimit. I Siguruari, është përgjegjës, lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij. Nëse vërtetohet se ka dhënë informacione të pasakta Siguruesi ka të drejtën të refuzojë të paguajë shumën e dëmshpërblimit. **13**. Siguruesi, ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të të Siguruarit dhe të kryejë inspektime për saktësime të dhënash. **14**. Kur, Polica e Sigurimit, humbet ose dëmtohet, në masën që bëhet e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguruarit, Siguruesi, duhet të lëshojë një dublikatë të saj. **15**. Kërkesa për Sigurim. Kupton kërkesën e të Siguruarit për sigurimin e mjetit të tij duke i dhënë përgjigje formularit standart ose të ngjashëm të përgatitur nga Siguruesi. I Siguruari ose personi i autorizuar nga ai, negocion dhe finalizon së bashku me agjentin ose specialistin e marrjes në sigurim, kërkesën për sigurim dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në të. Pas plotësimit të kërkesës për sigurim, i Siguruari nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore të cilat mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë. Në rast të moszbatimit të kushtit të mësipërm, Siguruesi çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit. Nën veprimin e këtij kushti bie edhe rasti kur I siguruari ndryshon qëllimin e përdorimit të mjetit pas lëshimit të Policës së Sigurimit. Në këtë rast ai duhet të njoftojë menjëherë Siguruesin për këtë ndryshim dhe ky i fundit ka të drejtë të shtojë primin ose të zgjidhë kontratën. Nëse ndodh rasti i sigurimit para se të bëhen këto ndryshime Siguruesi ka të drejtën të refuzojë të paguajë shumën e dëmshpërblimit. **16**. Natyra dhe Shtrirja. Kontrata e sigurimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, natyrën dhe shtrirjen e mbulimeve si dhe ndryshimet e primeve që rezultojnë nga ndryshimi i faktorëve të rrezikut. Pagimi i primit të sigurimit nga i Siguruari përbën shprehje të qartë dhe të pakushtëzuar të vullnetit të tij për njohjen dhe pranimin e Kushteve të Sigurimit, i mjaftueshëm më vete, pavarësisht nëse Polica është ose jo e nënshkruar. **17**. Kalimi i të Drejtave. Të drejtat dhe detyrimet e të Siguruarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në kontratën e sigurimit. Çdo parashikim apo pretendimin i ndryshëm me parashikimin e paragrafit të parë të kësaj pike është i pavlefshëm dhe e çliron siguruesin nga detyrimi për mbulim në sigurim.

PRIMI I SIGURIMIT - 18. Primi i sigurimit është çmimi i kontratës së sigurimit. Tarifa e tij përcaktohet në bazë të llogaritjeve, sipas mbulimit të zgjedhur, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik dhe vendoset në kontratën e sigurimit. **19**. I Siguruari, paguan primin/këstin e sigurimit detyrimisht përpara datës dhe orës kur është parashikuar të hyjë në fuqi polica (kontrata) e sigurimit. **20**. Pagesa, do të quhet e kryer, në momentin e kalimit të shumës së caktuar për llogari të Siguruesit. **21**. Në rast mospagimi të primit të sigurimit përpara datës dhe orës kur është parashikuar të hyjë në fuqi polica (kontrata) e sigurimit, polica (kontrata) e sigurimit pezullohet automatikisht dhe nuk krijon efekte juridike për Siguruesin deri në orën 24:00 të ditës që paguhet primi i sigurimit. Polica (kontrata) e sigurimit në rast se nuk është paguar primi i sigurimit do të qëndrojë e pezulluar për një periudhë kohore prej 30 ditë kalendarike dhe pas kalimit të këtij afati siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën automatikisht pa pasur nevojë për njoftim. I Siguruari në këtë rast është i detyruar të paguajë Siguruesin për kostot/shpenzimet administrative në masën 500 Lekë.

APLIKIMI I SISTEMIT BONUS – MALUS - 22. Në rinovimet e kontratave për mjetet që kanë përfituar dëmshperblim nga sigurimi KASKO, do të aplikohet MALUS që nënkupton rritje të primit të sigurimit, e cila do të jetë jo më pak se 15% e primit të llogaritur. **23**. Në rinovimet e kontratave për mjetet që nuk janë përfshirë në aksidente, pra nuk kanë përfituar dëmshpërblim sipas kontrates KASKO, do të aplikohet BONUS që nënkupton zbritje (ulje) të primit të sigurimit, ulje e cila do të jetë deri në masën 10% të primit të sigurimit.

PERIUDHA E SIGURIMIT - 24. Kjo kontratë vlen për dëmet që ndodhin brenda periudhës së sigurimit të përcaktuar në policë. **25**. Mbulimi në sigurim, fillon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë fillimi, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë mbarimi të mbulimit në sigurim në Policën e Sigurimit. Në çdo rast mbulimi në sigurim do të fillojë dhe do të krijojë efekte juridike për siguruesin vetëm pasi të jetë paguar primi i sigurimit. **26**. Në rastet kur pagesa e primit të sigurimit është kryer më parë, Përgjegjësia e Siguruesit, fillon në momentin kohor të përcaktuar në policë si datë fillimi, pavarësisht momentit të kryerjes së pagesës.

ZGJIDHJA DHE PËRFUNDIMI I POLICËS SË SIGURIMIT - 27. Kontrata e sigurimit, është e pavlefshme, nëse vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para lidhjes së kontratës. Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit në qoftë se: a. Nuk është paguar kësti vijues i primit të sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e rinovuara. Data e zgjidhjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit. b. Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga i Siguruari. I Siguruari mund ta zgjidhë kontratën: c. Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e zgjidhjes si dhe paguar shpenzimet administrative dhe të ndërmjetësimit. d. Kur të siguruarit ose përdoruesit të mjetit motorik iu është hequr dëshmia e aftësisë gjatë muajve të fundit.

28. Kontrata e sigurimit, përfundon: a. Nëse, rreziku i sigurimit (mjeti) pushon së qëni pas lidhjes së kontratës; ose kur pushon interesi i të siguruarit ndaj mjetit të siguruar; ose i siguruari kërkon ndërprerjen e kontratës për arsye të ndryshme kontrata e sigurimit zgjidhet dhe i siguruari përfiton primin e paguar për periudhën nga data e ndërprejes deri në përfundimin e kontratës, me kushtin që mjeti të mos ketë përfituar dëmshperblim gjatë periudhës së përdorimit. Siguruesi kthen vlerën e primit për periudhën e papërdorur, pasi janë mbajtur taksa, kontributi AMF-së dhe primi për periudhën që është aplikuar kontrata e sigurimit, së bashku me shpenzimet administrative në masën 500 Lekë. **28.1** Sipas nenit 1135 të Kodit Civil, kontrata zgjidhet automatikisht në çastin kur pushon interesi pasuror i të siguruarit ose i personit të tretë në dobi të të cilit është lidhur ajo (p.sh. kreditori, qiradhënës financiar etj), pavarësisht nga njoftimi i Siguruesit. I siguruari është i detyruar të njoftojë Siguruesin brenda 15 ditësh nga data e pushimit të interesit. Mosnjoftimi nuk pengon zgjidhjen e kontratës, por i siguruari mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar Siguruesit nga njoftimi i vonuar ose i munguar (p.sh. vazhdim i gabuar i mbulimit,). Nëse ekziston njëkohësisht interes i një personi të tretë të regjistruar në policë, kontrata mbetet në fuqi për të deri sa të pushojë edhe interesi i tij. Kalimi i pronësisë nuk ia kalon automatikisht policën pronarit të ri, ai mund të kërkojë brenda 10 ditësh lidhjen e një kontrate të re, me miratim të Siguruesit. Siguruesi kthen pjesën e primit të papërdorur nga data e pushimit të interesit, në përpjesëtim me kohën e mbetur, përveç kur ka ndodhur ngjarje e siguruar përpara asaj date.

DETYRIME - 29. I Siguruari, duhet të informojë me shkrim Siguruesin, për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat, konsiderohen thelbësore, nëse i Siguruari është pyetur me shkrim nga Siguruesi, ose ato janë të një natyre të tillë, që mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit, për të lidhur ose refuzuar kontratën, apo për kushtet që do të vendosë. Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit brenda 45 ditëve nga fillimi i saj, për shkak të pasaktësisë së informacionit të dhënë nga i Siguruari. Në këtë rast, i Siguruari, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e primit të sigurimit. **30**. I Siguruari, pas lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të njoftojë me shkrim çdo ndryshim në mjetin motorik, që sjell si pasojë rritjen e rrezikut. Siguruesi, ka të drejtë, nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit, ose të zgjidhë kontratën. Mosnjoftimi nga i Siguruari, sjell si pasojë çlirimin e Siguruesit nga detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit. **31**. I Siguruari, duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm, për të mbrojtur nga dëmtimet apo humbjet mjetin motorik, duke e mbajtur në kushte të sigurta dhe eficente.

DYSIGURIMI - 32. Nëse, i Siguruari, kryen apo ka kryer një tjetër sigurim (dysigurim) për mbulimin e rreziqeve në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, ai duhet t´i komunikojë SIGAL, emrin e siguruesit tjetër si edhe shumën e siguruar. Në rast se, qëllimisht apo për shkak të neglizhencës, i Siguruari, nuk plotëson detyrimet sipas paragrafit të mësipërm, Siguruesi, ka të drejtë të zgjidhë Policen e Sigurimit dhe të mos kthejë primin. **33**. Në rastin e dysigurimit, masa e dëmshpërblimit nga të dy kontratat së bashku, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e humbjes duke zbritur pjesën e zbritshme. Nese, i Siguruari, kryen sigurime të tjera me qëllim që, të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit, quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

NËNSIGURIMI - 34. Siguruesi dhe i Siguruari, mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorik për një Shumë Sigurimi më të vogël se vlera e tregut apo e blerjes së mjetit motorik të ri. Në këtë rast, dëmshpërblimi që do të përfitojë i Siguruari, do të llogaritet duke shumëzuar, vlerën e dëmit me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit, është raporti i shumës së siguruar kundrejt vlerës së mjetit në treg në momentin e ndodhjes së ngjarjes. **35.** Nënsigurimi, do të zbatohet, edhe nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar, është më e ulët se vlera e tregut.

MBISIGURIMI - 36. Nëse, Shuma e Siguruar, është përcaktuar më e lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorik të ri, Siguruesi dhe i Siguruari, kanë të drejtë të bëjnë ndryshimet përkatëse në Policën e Sigurimit, duke zvogëluar si Shumën e Siguruar ashtu dhe Primin e Sigurimit. **37**. Në cdo rast, kufiri i përgjegjësisë së Siguruesit, nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit tip mjet motorik të ri, duke zbritur pjesën e zbritshme. **38**. Nëse, i Siguruari, ka lidhur kontratën e sigurimit me qëllimin që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi, ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

RIVENDOSJA E SHUMES TE SIGURUAR - 39. Mbas pagesës së çdo dëmi shuma e siguruar do të rivendoset në vlerën e saj fillestare në rast se i siguruari paguan primin shtesë. Në rast se i siguruari nuk paguan primin shtesë, pra nuk e rivendoset shumën e siguruar, atëherë mjeti motorik qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në policën e sigurimit Kasko për një "shumë të re sigurimi" e barabartë kjo me diferencën e shumës së sigurimit fillestare dhe vlerës së dëmshpërblimit. Pra në dëmin e rradhës brenda vitit të sigurimit në rast se nuk ka rivendosur shumën e siguruar, i siguruari do të dëmshpërblehet sipas shumës së re të sigurimit, dhe aplikohet koefiçenti i nënsigurimit.

NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT DHE DËMSHPËRBLIMI - 40. Eshtë kusht parësor për përgjegjësinë e Siguruesit, që për çdo ngjarje që mund të jetë shkak për kërkesë për dëmshpërblim, i Siguruari, menjëherë duhet: a. Të njoftojë Siguruesin dhe Përfituesin, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes. Një njoftim i tillë, do të konsiderohet i dhënë Siguruesit, nëse është dhënë brenda 48 orëve nga ndodhja e ngjarjes. b. Në rastin e ndodhjes së aksidentit, i Siguruari, detyrohet menjëherë të njoftojë sipas rastit të sigurimit, Policinë Rrugore, të Rendit, Zjarrëfikësit brenda një afati prej 24 orësh nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të tij dhe të vërë në dispozicion të Siguruesit, vërtetimin e autoriteteve të lartpërmendura, lidhur me njoftimin e bërë. c. Të plotësojë formularin "Raportin Europian të Aksidenteve" për dëme në vlerë deri në 30.000 lekë (ligji nr.32.2021 neni 14) dhe t'ia paraqesë atë Siguruesit, të shoqëruar me të gjitha të dhënat identifikuese përkatëse të mjetit motorik, të dëmtuar apo humbur, foto të vendit të ngjarjes dhe mjetit të dëmtuar si dhe rrethanat perkatëse të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Formulari standart i njoftimit të rastit të sigurimit, duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërime të fakteve të rastit të sigurimit nga i Siguruari. Në rast të kundërt, Siguruesi, ka të drejtën, të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit. d. Të shmangë dhe minimizojë humbjet ose dëmtimet aq sa është e mundur. **41.** I Siguruari, për dëmet në mjetin e siguruar, paraqet kërkesë për dëmshperblim brenda afateve të parashikuara nga Kodi Civil, vetëm pasi ka berë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standart, ose me email ose sms në adresat e email dhe numrat e publikuar në faqen web. **42**. Siguruesi, gëzon të drejtën të clirohet nga detyrimet e tij për dëmshpërblim nëse: a. I Siguruari, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e tij; b. I Siguruari, përpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrembër ose mashtruese, faktet para Siguruesit, fakte të cilat kanë rëndësi për mundësinë dhe/ose masën e dëmshpërblimit. **43**. Siguruesi, ka të drejtë, të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur Rasti i Sigurimit, si edhe të kryejë ekspertizën e dëmit apo të humbjeve në mjetin motorik të siguruar, brenda 15 ditësh nga dita e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Gjatë kësaj periudhe, i Siguruari, është i detyruar të mbajë mjetin motorik të dëmtuar në dispozicion të Siguruesit, pa e riparuar atë. Siguruesi do të paguaj të Siguruarin, Përfituesin ose trashëgimtarin ligjor të tij për dëmet në mjetin motorik të siguruar, deri në limitin e përgjegjësisë, duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Dëmet me vlerë më të vogël se franshiza, nuk paguhen. **44**. Siguruesi, në varesi të dëmit, përcakton formën e dëmshpërblimit si më poshtë: a. Riparim i mjetit të dëmtuar, në pikën e riparimit të autorizuar nga Siguruesi. Nëse mjeti është nën garancinë e prodhuesit/koncesionarit, siguruesi merr përsipër garancinë e mjetit deri në mbarimin e afatit të garancisë përcaktuar nga prodhuesi/koncesionari. b. Pagesën e vlerës së dëmit të përllogaritur nga siguruesi dhe pranuar nga i siguruari. Në rast pagese vlere dëmi, kur dëmi konsiderohet dëm total, Siguruesi me pagesen e vlerës, mban reliktin e mjetit dhe i Siguruari bën kalimin e mjetit në favor të Siguruesit. c. Zëvendësim i mjetit të dëmtuar (në rast dëmi total të mjetit të siguruar), me një mjet tjetër analog me parametra të ngjashëm (tip mjeti, vit prodhimi, kilometrazhi, etj). Dëmshpërblimi do të jetë deri në vlerën e dëmit të ndodhur dhe në asnjë rast dëmshpërblimi nuk mund të tejkalojë limitin maksimal të përgjegjësisë të percaktuar në policën e sigurimit/pyetesorin, pasi është hequr dhe pjesa e zbritshme e përcaktuar në Policën e Sigurimit. **45**. Siguruesi, brenda 15 ditësh nga plotesimi i dokumentacionit detyrohet të dërgojë për riparim mjetin e dëmtuar / të kryejë pagesën e dëmshpërblimit ose në rast se nuk ka rast sigurimi të njoftojë refuzimin e kërkesës për dëmshperblim. Gjithashtu Siguruesi, mund të shtyjë kohën e pagesës: a. Për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit, për të marrë pagesën në raste investigimesh ose verifikimesh, lidhur me ngjarjen ose vlerësimin e dëmit. b. Në qoftë se, janë filluar hetime penale, në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit. c. Për aq kohë sa, i Siguruari, nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi. **46**. Kur vlera e dëmit, është më e lartë se 80% e shumës së siguruar, mjeti motorik do të konsiderohet dëm total. Në rast dëmi total, pjesa e mbetur e mjetit prej 20 % (relikti) mbahet nga I siguruari dhe dëmshpërblehet për diferencën ndërmjet shumës së siguruar (vlerës së mjetit në momentin e aksidentit) dhe reliktit. Nëse relikti kalon në pronësi te Siguruesit, I siguruari është i detyruar të bëjë çregjistrimin e mjetit tek autoritetet përkatëse. Me paraqitjen e vërtetimit/dokumentit të çregjistrimit, Siguruesi brënda 15 ditëve kalon shumën respektive të dëmshpërblimit në llogarinë e të Siguruarit dhe merr mjetin motorik në dorëzim/pronësi. **47**. Në rastin e vjedhjes totale, SIGAL, do të paguajë deri ne 50% të vlerës së dëmit, brenda një periudhe prej 90 ditësh, nga dita e marrjes së njoftimit lidhur me ngjarjen e sigurimit dhe pjesën e mbetur të dëmshpërblimit me përfundimin e procedurave investiguese dhe procedurave penale. **48**. Në rast se, është bërë dëmshpërblimi, deri në limitin e përgjegjësisë dhe mjeti gjendet, ai do të vihet në dispozicion të Siguruesit. I Siguruari, ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë, në rast të kundërt, Siguruesi përfiton pronësinë mbi mjetin duke bërë kalimin e pronësisë nga i siguruari tek Siguruesi. **49**. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe (ose) franshizë. Masa e pjesës së zbritshme dhe franshizës, vendoset në policën e sigurimit. Për çdo rast dëmi, Siguruesi, do të zbresë nga shpërblimi i llogaritur, pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute ose në përqindje. Siguruesi, nuk do të paguajë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në kontratën e sigurimit. **50**. Siguruesi, i njofton Përfituesit shumën e përllogaritur të dëmshpërblimit. Përfituesi, me marrjen e njoftimit e udhëzon Siguruesin, për mënyrën dhe destinacionin e pagesës së shumës së dëmshpërblimit. **51.** Ky sigurim, nuk do të dëmshpërblejë dëme, për të cilat Përfituesi/i Siguruari përfiton dëmshpërblim nën kontrata të tjera. Bën përjashtim, pjesa e dëmit, që tejkalon shumën që do të ishte mbuluar nën kontratat e tjera, në rastin kur Polica e përcaktuar nga këto kushte sigurimi, të mos ishte në fuqi. **52**. Në rast pagese dëmshpërblimi, sipas kësaj police, Siguruesi, zë vendin e Përfituesit/ të Siguruarit, për të kërkuar kthimin e shumës/të drejtave pasurore, ose të çdo të drejte tjetër legale, ndaj çdo personi ose organizate që konsiderohet shkaktar i demit dhe/ose siguruesit të tij referuar dhe përcaktimeve të bëra në Kodin Civil. I Siguruari, do të veprojë, me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta dhe nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta. **53**. Pas pagesës së dëmshpërblimit, mjeti motorik, qëndron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në kontratë, për një shumë të barabartë me diferencen midis shumës së sigurimit dhe dëmshpërblimit të paguar. I Siguruari, mund të rivendosë, shumën e siguruar, kundrejt pagesës së primit shtesë të llogaritur nga Siguruesi. **54**. Për çdo marrëveshje që nuk zgjidhet me mirëkuptim, palët, do t'i drejtohen Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Shqiptar ku ka qëndrën i padituri apo ku është shkaktuar dëmi. **55**. Për gjithçka jo të parashikuar në këto kushte, do të aplikohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil. **56.** Pjesë përbërëse dhe të pandarë të Kontratës së Sigurimit KASKO janë: Polica e Sigurimit, Kushtet e Përgjithshme dhe të vecanta në tërësi, Formulari i Kërkesës për marrje në sigurim dhe çdo dokument tjetër që i bashkëlidhet.

MBROJTJA E TË DHENAVE PERSONALE - 56. I siguruari është njohur me deklaratën e privatësisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL INSURANCE GROUP sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale'')) si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Në çdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të bëhet në përputhje me rregullat dhe proçedurat e përcaktuara në Ligjin 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale''.

E DREJTA E INFORMIMIT - 57. I siguruari ka të drejtën të informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para hyrjes në fuqi të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nëpërmjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet www.sigal.com.al apo broshurave informative të përdoruara nga shoqëria. I siguruari është informuar nga Siguruesi përpara hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat juridike të siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, proçedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe mënyra e pagesës së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompesueshme dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

E DREJTA E TË SIGURUARIT PER TU ANKUAR - 58. I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se çmojnë se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund të paraqitet në formë elektronike (e-mail) ose me shkrim në adresën postare të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do ti përgjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do të japë çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve të përcaktuara në ligj. Kjo kontratë sigurimi hartohet dhe zbatohet në përputhje me kushtet e përcaktuara si më siper, Kodin Civil, Ligjin nr.52 të vitit 2014 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve". **59.** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve zgjidhet me mirëkuptin, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Shqiptar, ku ka qëndrën i padituri apo ku është shkaktuar dëmi. **60.** Korrespondenca midis Siguruesit dhe të Siguruarit do të zhvillohet me letër ose letër rekomande ose nëpëmjet mjeteve të njohura elektronike. Për gjithçka jo të parashikuar në këto kushte, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni tjetër në fuqi.

I siguruari deklaron se ka analizuar, kuptuar dhe miratuar kushtet e përgjithëshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit Kasko dhe ne vecanti eshte njohur dhe miraton nenet: nenin 3; nenin 4; nenet 24-26; nenet 29-31 dhe nenet 40 - 56 te ketyre Kushteve. PAGESA E PRIMIT TË SIGURIMIT DHE LËSHIMI I POLICËS SË SIGURIMIT VËRTETOJNË SE PALËT KANË RËNË DAKORD ME INFORMACIONIN E DHËNË PARAPRAKISHT, KANË LEXUAR DHE KUPTUAR TË GJITHA TERMAT DHE KUSHTET E KËSAJ KONTRATË SIGURIMI, DHE PRANOJNË ME VULLNET TË LIRË T'I RESPEKTOJNË DHE ZBATOJNË ATO.